

RAPORT MONITORIMI

3

Ecuria e Ngritjes së Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

**Risitë e ushtrimit të kompetencave të Këshillit
të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë
të Prokurorisë në drejtim të emërimit
të gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm**

Tiranë
(Qershor 2019)



Raport Përfundimtar

Ecuria e Ngritjes së Gjykatave të Posaçme
Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
dhe Strukturës së Posaçme
Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

Risitë e ushtrimit të kompetencave
të Këshillit të Lartë Gjyqësor
dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në drejtim
të emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm

Tiranë
(Qershor 2019)



Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Ky Raport Monitorimi u përgatit nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes në kuadër të projektit: “**Forcimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe komunikimit të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar**”, i mbështetur nga Programi i Reformës në Drejtësi, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Autorë: **Arjan DYRMISHI**, Drejtues i projektit, **Mirsada HALLUNAJ**, Hulumtuese e projektit
Përpunimi Grafik, Ergys Temali

Lista e shkurtimeve

BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
EURALIUS	Projekti "Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri"
GJKR	Gjykata e Krimeve të Rënda
GJKKKO	Gjykatat Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
KPK/Komisioni	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
OPDAT	Zyra Tejqeaneike për Zhvillimin, Ndihmën dhe Trajnimin e Prokurorisë
PKR	Prokuroria e Krimeve të Rënda
Rregullore	Rregullore "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar"
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Tabela e Përmbajtjes

6	Përmbledhje Ekzekutive
9	Hyrje
12	Reformimi në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të sistemit gjyqësor: Konstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe ngritja e Gjykatave të Posaçme
12	Riorganizimi i kompetencave dhe strukturës së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD)
13	Risitë në menaxhimin e sistemit gjyqësor
13	Konstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ)
15	Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor në verifikimin e përmbushjes së kushteve të sigurisë për gjyqtarët dhe nëpunësit civilë: Emërimi i përkohshëm dhe i përhershëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme KKKO
17	Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: Ecuria e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të
20	Reformimi i sistemit të prokurorisë: Problematikat e evidentuara në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ngritja e Prokurorisë së Posaçme
20	Nevoja për ngritjen dhe funksionimin e Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH)
22	Konstituimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP)
24	Kompetencat e KLP në drejtim të Vlerësimi i aftësive profesionale për prokurorët e posaçëm dhe nëpunësit civilë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar
25	Miratimi i Rregullores për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për prokurorë të posaçëm
27	Krijimi i Prokurorisë së Posaçme dhe zgjedhja e drejtuesit të saj
29	Roli i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) në zbatimin e reformës në sistemin e drejtësisë
30	Zyra për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (USKOK), Kroaci

32	ANEKS I
33	ANEKS II
35	ANEKS III
36	ANEKS IV
37	ANEKS V
38	ANEKS VI

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ngritja dhe funksionimi i Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK) përbën një nga objektivat kryesore të zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë. Paketa e ndryshimeve kushtetuese u miratua unanimitisht me 140 vota pro nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 22 korrik 2016 me Ligjin Nr.76/2016.¹ 7 ligjet e paketës së ndryshimeve kushtetuese reflektojnë problematikat e dala si rezultat i një analize rreth 2 vjeçare të të gjithë sistemit të drejtësisë në vend. Për këtë arsye zbatimi i ligjeve të reformës parashikoi një transformim gjithëpërfshirës të të gjitha organeve pjesë e sistemit gjyqësor dhe prokurorisë si edhe ngritjen e organeve të reja.

Pjesë e ndryshimeve të përmendura më lart dhe një nga proceset kryesore të reformës në sistemin e drejtësisë është rivlerësimi kalimtar, apo vetting-u, i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend. Konfirmimi në detyrë i tyre nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), apo në rast ankimi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), përbën një nga hapat më të rëndësishëm të zbatimit të reformës. Së pari, ky proces ka qenë thelbësor, pasi vetting-u i gjyqtarëve dhe prokurorëve përcakton mundësinë për vazhdimin e funksioneve të tyre dhe së dyti, ky proces është kyç për të bërë të mundur emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve kandidatë në institucionet e reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ecuria e deritanishme e këtij procesi, ka sjellë shkarkimin e një numri të konisderueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh, duke sjellë në raste të caktuara edhe vonesa në ngritjen e organeve të reja të drejtësisë për shkak të shtyrjes së afateve dhe procedurave respektive. Specifikisht, me zhvillimin e seancës së parë dëgjimore nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në muajin mars 2018 filloi procesi për rivlerësimin me përparësi për kandidatët për anëtarë gjyqtarë dhe anëtarë prokurorë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Për shkak të rëndësisë në menaxhimin e sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, krijimi i këtyre dy organeve është konsideruar një hap mjaft i rëndësishëm në drejtim të ushtrimit të kompetencave në emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm. Duke përfshirë rishpalljen e thirrjeve për kandidatë në këto organe, procesi i rivlerësimit të tyre përfundoi në muajin nëntor 2018. KLGJ dhe KLP u konstituan gjatë muajit dhjetor 2018 respektivisht pas zgjedhjes së anëtarëve nga Mbledhjet e Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në këtë mënyrë këto organe filluan edhe ushtrimin e kompetencave në drejtim të zbatimit të hapave ligjorë për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm.

Ngritja e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është parashikuar të realizohet nëpërmjet një procesi tranzitor të transformimit të Gjykatave aktuale të Krimeve të Rënda. Për këtë arsye legjislacioni për gjyqtarët aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda ka parashikuar fillimisht emërimin e përkohshëm të tyre në Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në rastet kur ndaj gjyqtarëve ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe kur gjyqtarët si edhe familjarët e afërt të tyre kanë dorëzuar tek KLGJ si organ emërtese deklarat për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake. Emërimi i përkohshëm duhej të realizohej nga Këshilli i Lartë Gjyqësor brenda muajit shkurt 2018, dy muaj nga krijimi i këtij organi. KLGJ filloi procedurat për emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të

¹ Ligj nr. 76/2016 datë 22.7.2016. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/138-2016.pdf

Krimeve të Rënda në gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në fund të muajit dhjetor 2018 dhe të gjithë gjyqtarët (14) e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kanë pranuar të japin pëlqimin për kufizimin e privatësisë, ndërkohë 8 nga 11 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda kanë pranuar të japin pëlqimin dhe dorëzojnë deklaratat respektive.

Sa i përket emërimit të përherhshëm, gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda mund të emërohen në Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kur përveç dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake së bashku me familjarët e afërt, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit dhe kanë përmbushur gjithashtu kriteret për ngritjen në detyrë sipas legjislacionit në fuqi. Deri në fund të muajit Maj, 4 gjyqtarë të Gjykatave të Krimeve të Rënda janë konfirmuar në detyrë, por një prej tyre është zgjedhur anëtar në KLGJ duke u përjashtuar nga gara dhe vendimi për një tjetër është ende në proces ankimimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ndërkohë, Kryetari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda u shkarkua nga KPK gjatë muajit prill 2019. Ende një pjesë e konsiderueshme e gjyqtarëve të krimeve të rënda pritet të përfshihen në kalendarin e seancave dëgjimore të KPK.

Nga ana tjetër, edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë filloi procedurat për ngritjen në detyrë të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në 7 janar 2019 me shpalljen e thirrjes së parë për aplikime në organin më të rëndësishëm të hetimit të veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Me shtyrjen e afatit të dytë deri në datën 6 shkurt, 28 kandidatë aplikuan në total për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Pas skualifikimit të 3 prej tyre, kandidatë jashtë sistemit të prokurorisë dhe dorëheqjes së njërit prej tyre për shkak të zgjedhjes si anëtar i KLP, 24 kandidatë në total janë në garë për prokurorë të posaçëm.

Pas seleksionimit të fazës së parë, bazuar në plotësimin e kushteve ligjore, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vazhduar me procedurat në drejtim të vlerësimit dhe përzgjedhjes së 24 kandidatëve. Gjatë muajit prill 2019 KLP miratoi Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, e cila përcakton në mënyrë të detajuar procedurat dhe kriteret për vlerësimin e kandidatëve për prokuror të posaçëm. Ky proces është parashikuar të përfundojë javën e parë të muajit qershor 2019 për të vazhduar më pas me procesin e intervistimit të kandidatëve.

Në të njëjtën kohë me qëllim avancimin e procesit të rivlerësimit të kandidatëve, të cilët nuk i janë nënshtruar ende rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përfunduar dhe miratuar Raportet për Vlerësimin e Aftësive Profesionale të 10 nga 24 kandidatëve në garë. Pas këtij hapi, KLP do të përcjellë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit apo në rastin e ankimeve Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, emrat e kandidatëve në garë me qëllim rivlerësimin e tyre me përparësi. Konfirmimi në detyrë nga KPK dhe KPA është një kusht i domosdoshëm për emërimin dhe ngritjen në detyrë të kandidatëve nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Aktualisht, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procedurat e rivlerësimit për të 24 kandidatët në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, ndërkohë që deri tani nga KPK janë konfirmuar në detyrë 4 prej tyre, vendimet e 2 prej të cilëve janë ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

Operacioni Ndërkombëtar i monitorimit (ONM) ka luajtur një rol mbikqyrës gjatë procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Një pjesë e vendimeve të marra nga Komisioni

i Pavarur i Kualifikimit janë ankimuar nga ky mission pwrmes institucionit tw Komisionerit Publik.

Megjithëse ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikon në ditën e 300 të hyrjes së tij në fuqi kalimin e çështjeve të cilat janë në gjykim para gjykatave të krimeve të rënda në kompetencën e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ngritja e harmonizuar e Gjykatave të Posaçme me Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është faktor kryesor me qëllim respektimin e të drejtave të të pandehurve, pasi çështjet në kompetencë të këtyre Gjykatave do të ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme. Për këtë qëllim, krijimi i këtyre dy strukturave është parashikuar të ngrihet në mënyrë paralele.

HYRJE

Nevoja për transformimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykata të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ngritja e Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), u përcaktuan bazuar në problematikat e evidentuara në dy dokumentet strategjike të reformës në sistemin e drejtësisë, të cilat përfshinë Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri² dhe Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë.³

Këto dy dokumente, së bashku me Planin e Veprimit⁴ dhe Paketën e Projektligjeve⁵ u përgatitën dhe u miratuan nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë,⁶ i krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë në nëntor të vitit 2014 dhe i përbërë nga një grup ekspertësh të nivelit të lartë, konsulentë të jashtëm dhe një sekretariat teknik, me qëllim realizimin e tre objektivave kryesore: 1) kryerjen e një analize të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të funksionimit të sistemit duke evidentuar problematikat dhe nevojat ekzistuese; 2) përcaktimin e objektivave nëpërmjet hartimit të një dokumenti strategjik; dhe 3) ofrimin e propozimeve për ndryshime respektive kushtetuese dhe ligjore, me ndikim në zbatimin e reformës.

Megjithëse Shqipëria prej më shumë se dy dekadash ka adoptuar një kuadër ligjor⁷ dhe ka krijuar një sërë mekanizmesh dhe strukturash institucionale⁸ në drejtim të masave kundër korrupsionit, progresi i ulët në këtë drejtim gjatë gjithë këtyre viteve⁹ dhe në mënyrë të veçantë nivelet shqetësuese të korrupsionit në nivele të larta, sollën nevojën për të ndërmarrë një nga reformat më gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë, jo vetëm në vend, por edhe në krahasim me vende të tjera të rajonit, të cilat kanë kaluar një përvojë të ngjashme me Shqipërinë sa i përket korrupsionit dhe masave të ndërmarra.¹⁰

Pavarësisht se në pjesën më të madhe të këtyre vendeve janë ndërmarrë nisma ligjore dhe institucionale në drejtim të luftës kundër korrupsionit, duhet theksuar fakti që në asnjë prej këtyre vendeve këto masa nuk kanë përfshirë reformimin e të gjitha institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe aspekteve respektive ligjore. Vetë ndryshimi i Kushtetutës së Republikës së

² Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (Qershor, 2015), Burimi: Euralius:

<http://www.euralius.eu/old/images/pdf/Analize-e-Sistemit-te-Drejtësisë-ne-Shqipëri.pdf>

³ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë (Projekt-24 korrik 2015), Burim: Euralius: http://www.euralius.eu/old/images/Justice-Reform/Strategjia-ne-Refomen-e-Sistemit-te-Drejtësisë_24-07-2015.pdf

⁴ Burimi Euralius: (version 23.07.2015): <http://www.euralius.eu/old/images/Justice-Reform/Plan-i-Veprimit.pdf>

⁵ Reforma në Drejtësi, Ligjet e miratuara nga procesi i Reformës në Drejtësi, Burimi: Euralius: <http://www.euralius.eu/old/images/Justice-Reform/AL-Justice-Reform-Status-17-11-20.pdf>

⁶ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Vendim nr. 96/2014 datë 27.11.2014, Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë: <https://qbz.gov.al/share/fsGZ68F7T4CYHU-JCa0VeA>

⁷ Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI): <http://rai-see.org/legislation-albania-anti-corruption-institutional-framework/>

⁸ Po aty: <http://rai-see.org/preventive-albania-anti-corruption-institutional-framework/>

⁹ Shiko Aneks I

¹⁰ Shiko Aneks I

Shqipërisë përforcoi nevojën e këtyre ndryshimeve thelbësore, duke shërbyer si një garanci thelbësore për nevojën e zbatimit të reformës.

Nivelet e larta të korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë qenë një çështje shqetësuese dhe për vende të tjera të rajonit, të cilat si rezultat i specifikave politike, ekonomike dhe sociale kanë pësuar luhatje të ndjeshme në drejtim të arritjes së rezultave në luftën kundër korrupsionit.




Tabela 1: Nivelet e korrupsionit në vende të Ballkanit Perëndimor gjatë viteve 2012-2018, Burimi, Transparency International

Në këtë drejtim, të gjitha vendet e rajonit gjatë viteve të fundit kanë ndërmarrë një sërë masash në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Një pjesë e tyre kanë konsistuar në hartimin dhe miratimin e legjislacionit respektiv mbi korrupsion si edhe në drejtim të ngritjes së kapaciteteve administrative apo institucionale. Qasja, kompetencat dhe pavarësia e ngritjes së këtyre strukturave ndryshojnë nga njëri vend tek tjetri, megjithatë rezultojnë se jo vetëm një kuadër i përgjithshëm rregullator është krijuar, por në disa prej vendeve është realizuar edhe ngritja e strukturave specifike në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

	Strukturat të specializuara për veprat e korrupsionit dhe krimit të organizuar
Shqipëria	Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK) Prokuroria e Posaçme & Byroja Kombëtare e Hetimit
Kroacia	Zyra për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (USKOK) Zyra Kombëtare e Policisë për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PNUSKOK)
Mali i Zi	Zyra e Prokurorit Special të Shtetit
Maqedonia e Veriut	Sëktori për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin/Ministria e Brendshme
Bosnja dhe Hercegovina	Agjencisë Shtetërore për Investigim dhe Mbrojtje Departamenti Special për Krimin e Organizuar, Krimin Ekonomik dhe Korrupsionin (Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm)
Serbia	Agjencia anti-korrupsion Këshilli anti-korrupsion Zyra e Prokurorit për Krimin e Organizuar

* Tabela 2: Modele të strukturave të specializuara për veprat e korrupsionit dhe krimit të organizuar në vende të Ballkanit Perëndimor

Në mënyrë të veçantë Zyra për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK) e themeluar në Kroaci në vitin 2001, ka përbërë një model specifik të dedikuar në mënyrë të veçantë në investigimin dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivele të larta.

Në kuadër të zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë dhe në mënyrë të veçantë ngritjes së institucioneve kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Shqipëria po zbaton një model të ngjashëm në rastin e ngritjes së Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH).

Për këtë arsye siç do të përshkruhet më poshtë, fillimi i zbatimit të reformës në Shqipëri, shënoi fillimin e një procesi me sfida specifike dhe me ndikim në ecurinë në kohë dhe përmbajtje të përmbushjes së objektivave dhe qëllimeve të vetë reformës dhe ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

I. REFORMIMI NË KUADËR TË PËRMIRËSIMIT TË MENAXHIMIT TË SISTEMIT GJYQËSOR: KONSTITUIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR (KLGJ) DHE NGRITJA E GJYKATAVE TË POSAÇME KKKO

Problematikat e evidentuara në menaxhimin e sistemit gjyqësor dhe atë të prokurorisë krijuan nevojën për reformimin e strukturave ekzistuese siç ishte rasti i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) apo ngritjen e organeve të reja me kompetenca në krijimin e strukturave të specializuara në drejtim të hetimit të veprave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, specifikisht Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për këtë arsye, konstitucioni i dy institucioneve të reja, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është konsideruar si një nga fazat më të rëndësishme për fillimin e ushtrimit të kompetencave dhe aktivitetit në drejtim të qeverisjes së sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, duke përfshirë gjithashtu edhe emërimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si edhe vlerësimin, përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

I.1. Riorganizimi i kompetencave dhe strukturës së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD)

Menaxhimi, organizimi dhe funksionimi i sistemit gjyqësor në vend janë konsideruar në vazhdimësi çështje shqetësuese, si pasojë e mungesës së pavarësisë, paanshmërisë, përhapjes së gjerë të korrupsionit në rradhët e gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, mungesës së profesionalizmit, të përgjegjshmërisë dhe transparencës, të efijencës, si dhe mungesës së theksuar të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.¹¹ Si rezultat, Analiza e Sistemit të Drejtësisë evidentoi ndër të tjera një sërë problematikash në fushën e qeverisjes së gjyqësorit dhe në mënyrë të veçantë të organeve qeverisëse të gjyqësorit, të tilla si:¹²

- i. fragmentimi i përgjegjësive të qeverisjes në shumë duar;
- ii. roli i dobët i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkak të mungesës së kompetencave në fusha të rëndësishme të qeverisjes (p.sh. administrata gjyqësore, buxheti, trajnimi etj.) dhe të kapaciteteve;
- iii. roli i dobët i Konferencës Gjyqësore Kombëtare (KGJK) në forcimin e etikës në radhët e gjyqësorit dhe mbrojtjen e interesave të tij;
- iv. prirja për korporatizëm gjyqësor si rezultat i përbërjes aktuale e KLD-së, ku 2/3 e anëtarëve janë gjyqtarë;
- v. shkalla e ulët e kolegjalitetit në punën e KLD-së si rezultat i angazhimit me kohë të pjesshme i anëtarëve të saj;
- vi. cilësia e dobët e anëtarësisë së KLD-së si rezultat i mangësive të procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen e anëtarëve të KLD-së;
- vii. mbivendosja e kompetencave të KLD-së dhe ministrit të Drejtësisë në lidhje me inspektimet e gjykatave dhe shqyrtimin e ankesave kundër gjyqtarëve;
- viii. paqartësitë në lidhje me rolin e ministrit të Drejtësisë në sferën e administrimit gjyqësor veçanërisht në lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve, marrëdhëniet

¹¹ Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë (SRSD), faqe 10

¹² Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë (SRSD), faqe 12

me publikun dhe medien, sigurinë në gjykata dhe menaxhimin e personelit mbështetës administrativ etj.

Në funksion të riorganizimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe përmirësimit të të gjitha mangësive dhe problematikave të përmendura më lart si dhe me qëllim mirëqeverisjen e sistemit gjyqësor në funksion të pavarësisë, përgjegjshmërisë, eficiencës dhe transparencës, një nga hapat kyç që parashikoi reforma në sistemin e drejtësisë ishte krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky organ u ndërtua duke ndryshuar në përmbajtje dhe cilësi në lidhje me kompetencat, të cilat janë më të mëdha dhe gjithëpërfshirëse në administrimin e pothuajse të gjitha aspekteve të gjyqësorit. Në mënyrë të veçantë Këshilli i Lartë Gjyqësor do të luajë një rol thelbësor në emërimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

1.2. Risitë në menaxhimin e sistemit gjyqësor

Me qëllim adresimin e të gjitha problematikave më lart, reforma në sistemin e drejtësisë parashikoi realizimin e disa objektivave në drejtim të përmirësimit të kompetencave dhe funksionimit të organeve përgjegjëse për menaxhimin e sistemit gjyqësor dhe me rol thelbësor në ngritjen dhe funksionimin e Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ndryshimet, të cilat do të reflektoheshin në ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor parashikuan një sërë masash, duke përfshirë ndër të tjera:¹³

- i. Fuqizimin e rolit të KLD-së, ndarjen e qartë të përgjegjësive të qeverisjes mes institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe ekzekutivit, shmangien e fragmentimit të përgjegjësive dhe nxitjen e procesit të bashkëpunimit institucional;
- ii. Rishikimin e përbërjes, formulës së përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve dhe mënyrës së funksionimit të KLD-së, duke kryer ndërhyrjet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore;
 - kriteret për anëtarët, zvogëlimin e raportit të anëtarë gjyqtarë/jo-gjyqtarë, përfaqësimin nga nivelet e gjyqësorit të anëtarëve gjyqtarë, rregullimi i veprimtarisë së anëtarë dhe zgjedhjes së kryetarit, përcaktimi dhe rregullimi i procedura transparente gjatë procesit të vendimmarrjes, etj.
- iii. Krijimin e mundësive që strukturat përgjegjëse për qeverisjen e gjyqësorit të kenë kapacitetet e duhura për zhvillimin e politikave dhe të strategjive të sektorit;
- iv. Vendosjen, si rregull, të hartimit të detyrueshëm të raporteve të veprimtarisë vjetore.

Zbatimi i risive të lartëpërmendura në mënyrën e funksionimit të sistemit gjyqësor, do të reflektohej me ngritjen dhe konstituimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në dhjetor 2018.

1.3. Konstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ)

Këshilli i Lartë Gjyqësor është aktualisht organi kolegjal më i rëndësishëm qeverisës i sistemit gjyqësor, i cili ka në përbërje 11 anëtarë, 6 prej të cilëve gjyqtarë nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor (3 gjyqtarë të shkallës së parë dhe së paku 1 prej tyre gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë jashtë Tiranës; 2 gjyqtarë të apelit dhe së paku 1 prej tyre gjyqtar në një

¹³ Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë (SRSD), faqe 13-14

gjykatë të apelit jashtë Tiranës dhe 1 gjyqtar nga Gjykatën e Lartë) dhe 5 anëtarë jo gjyqtarë, të cilët u zgjedhën nga Kuvendi i Shqipërisë në votimin e tretë të datës 8 shkurt 2018.¹⁴

- Vetting-u i kandidatëve gjyqtarë në KLGJ

Vonesat në konstituimin e këtij institucioni, i cili u parashikua të krijohej 8 muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese të miratuara në korrik të vitit 2016,¹⁵ u shkaktuan si rezultat i procesit të rivlerësimit me përparësi të gjyqtarëve kandidatë për të qenë pjesë e këtij organi,¹⁶ i cili përfundoi në nëntor 2018, duke sjellë edhe shtyrjen në kohë të ngritjes së tij. Fillimisht 14 kandidatë gjyqtarë shprehën interesin e tyre për të qenë pjesë e 6 vendeve vakante të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndër të cilët 9 u konfirmuan në detyrë, 4 u shkarkuan dhe 1 subjekt i kësaj liste u dorëhoq. Megjithatë procesi i vetting-ut për këta kandidatë u zgjat edhe më tepër në kohë si pasojë e mosplotësimit të pozicioneve respektive dhe rishpalljes së thirrjeve për aplikime nga Gjykata e Lartë deri në dy herë.¹⁷ Në 13 shtator 2019 Gjykata e Lartë shpalli listën përfundimtare të kandidatëve gjyqtarë për në Këshillin e Lartë Gjyqësor¹⁸ duke hapur rrugë procesit për zgjedhjen e tyre. Në 12 dhjetor 2018 me kërkesë të kryetarit të Gjykatës së Lartë u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve,¹⁹ e cila nëpërmjet votimit zgjodhi 6 anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor.²⁰

- Kapacitetet logjiste, administrative dhe njerëzore të KLGJ

Me konstituimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe zhvillimin e mbledhjes së parë në datën 20 dhjetor 2018,²¹ filluan të ndërmerren hapat e parë në drejtim të aspekteve logjistike, buxhetit dhe stafit administrativ. Këshilli i Lartë Gjyqësor në fund të muajit janar 2019, i dërgoi Kuvendit të Shqipërisë shkresën zyrtare dhe relacionin respektiv mbi planifikimin për staf administrativ dhe buxhetin për vitin 2019.²² Pas shqyrtimit dhe miratimit të Vendimit “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor” nga Komisioni për Çështjet Ligjore,

¹⁴ Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 18/2018 Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas Ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”:

<http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2019/VENDIM%20KUVENDI%20nr.%2018-2018,%20date%208.2.2018.pdf>

¹⁵ Kushtetuta e Shqipërisë”, Neni 179/5

¹⁶ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Shorti për subjektet e listës së përparësisë:

<http://kpk.al/2017/12/12/njoftim/>

¹⁷ Gjykata e Lartë, Njoftim – Rishpallje e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga gjyqtarët e Gjykatave të Apelit jashtë Tiranës për Pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rishpallje_e_thirrjes_per_paraqitjen_e_shprehjes_se_interesit nga_gjyqtaret_e_gjykatave_te_apelit_jashte_Tiranes_per_pozicionin_e_anetarit_te_5317_1.php

¹⁸ Gjykata e Lartë, Njoftim për shpalljen e listës përfundimtare të kandidatëve gjyqtarë për Këshillin e Lartë Gjyqësor:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rezultatet_e_Kerkimit_2254_1.php?search=NJOFTIM+P%C3%8BR+SHPALLJEN+E+LIST%C3%8BS+P%C3%8BRFUNDIMTARE+T%C3%8B+KA

¹⁹ Gjykata e Lartë, Njoftim “Për thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”: file:///C:/Users/user/Downloads/publikim_copy_1.pdf

²⁰ Gjykata e Lartë, Vendim Nr. 242, datë 12.12.2018 Për shpalljen e kandidatëve fitues për anëtarë gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/untitled_1885.pdf

²¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Vendim Nr.4, datë 20.12.2018 “Mbi deklarimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor”:

<http://klgj.al/vendime/vendim-nr-4-dat%C3%AB-20-12-2018>

²² Kuvendi i Shqipërisë, Projektvendim “Për miratimin e strukturës organizative të KLGJ”:

<http://www.parlament.al/Projekte/PPPDetaile/462>

Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës,²³ Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancën plenare të datës 26 shkurt organikën dhe buxhetin e institucionit.²⁴

Aktualisht, në kuadër të aspekteve logjistike dhe në funksion të prezantimit të veprimtarisë së institucionit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përdorur faqen zyrtare në internet të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë,²⁵ e cila është modifikuar vetëm në disa aspekte në përputhje me aktivitetet dhe aktet ligjore të fundit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu Këshilli ka ngritur edhe katër komisionet e përhershme ku përfshihen:²⁶

- Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
- Komisioni Disiplinor
- Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
- Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

1.4. Kompetencat e KLGJ-së në verifikimin e përmbushjes së kushteve të sigurisë për gjyqtarët dhe nëpunësit civilë: Emërimi i përkohshëm dhe i përhershëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme KKKO

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në funksion të fillimit të ushtrimit të kompetencave të këtyre institucioneve. Në ndryshim nga procesi i ngritjes dhe funksionimit të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), i cili përfshin krijimin e dy institucioneve të reja, siç janë Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), krijimi i Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar do të realizohet bazuar në një proces gradual të transformimit të Gjykatave ekzistuese të Krimeve të Rënda (Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda) nëpërmjet emërimit të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme KKKO.

Megjithatë, përpara emërimit dhe caktimit në detyrë në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda do të duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë, të cilat përfshijnë:²⁷

1. kontrollin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës;
2. dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake; si dhe

²³ Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut miratoi numrin e punonjësve për KLGJ dhe KLP, për vitin 2019: <http://www.parlament.al/News/Index/7191>

²⁴ Kuvendi i Shqipërisë, Seanca Plenare, e martë 26 shkurt 2019: <http://www.parlament.al/Document?tipld=1&dokumentId=3596>

²⁵ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ): www.klgj.al

²⁶ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Vendim Nr.13, datë 18.01.2019 “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor”: <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-13-dat%C3%AB-18-01-2019>

²⁷ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Neni 6/1

3. dhënien e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Në lidhje me plotësimin e kushtit të parë, i cili i referohet kontrollit të pasurisë dhe figurës, organi përgjegjës për verifikimin e këtij kriteri do të jetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.²⁸ Ndërkohë, në lidhje me dorëzimin e deklaratave respektive për kontrollin e llogarive bankare dhe telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve dhe të familjarëve të afërt të tyre do të jetë Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili do të shërbejë si organ emërtese për depozitimin e këtyre deklaratave.

Duke qenë se përmbushja e këtyre kushteve nuk mund të realizohet në mënyrë të njëkohshme, gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda qëndrojnë në detyrë në pozicionin e tyre respektiv deri në momentin e krijimit të Gjykatave të Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.²⁹ Në funksion të transformimit gradual të Gjykatave të Krimeve të Rënda dhe kalimit të gjyqtarëve të këtyre Gjykatave në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, legjislacioni ka parashikuar fillimisht për gjyqtarët aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda *emërimin e përkohshëm* dhe më pas *emërimin e tyre të përhershëm* në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat KKKO është parashikuar për të krijuar mundësinë e vijimësisë së funksionimit të këtyre institucioneve dhe për të respektuar të drejtën e të pandehurve për një gjykim të drejtë.

- Emërimi i përkohshëm

Emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar realizohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili cakton gjyqtarin përkohësisht në nivelin përkatës në Gjykatën e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar në rastet kur:

- gjyqtarët japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;³⁰
- anëtarët e afërt të familjes japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;
- ndaj gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Krimeve të Rënda ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendim të formës së prerë.³¹

Gjyqtarët në detyrë në Gjykatat e Krimeve të Rënda nuk mund të kalojnë dhe të emërohen në Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në rastet kur:

- ndaj gjyqtarëve janë marrë masa disiplinore në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar;³²

²⁸ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Neni 57/11

²⁹ Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 162/1

³⁰ Ligji Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Neni 6/1-4

³¹ Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 162/3

³² Ligji 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VII, Nenet 56-61

- në rastin e përfundimit të statusit të magjistratit;³³
- apo në rastin kur gjyqtarët në detyrë pranë gjykatave të krimeve të rënda apo familjarët e tyre të afërt nuk pranojnë të japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake.³⁴

Emërimi i përkohshëm është parashikuar të realizohet dy javë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, organ i cili u konstitua në dhjetor 2018 duke sjellë që afati i emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda të kishte përfunduar brenda muajit shkurt 2019. Ndërkohë, që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procedurat e rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda (Aneks III) ende nuk ka një deklaratë apo njoftim zyrtar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me gjyqtarët dhe familjarët e tyre të afërm, të cilët kanë pranuar të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe telekomunikimeve vetjake.

- Emërimi i përhershëm

Emërimi i përhershëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar realizohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili cakton në mënyrë të përhershme gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me kërkesë të tyre, nëse:

- gjyqtari kalon me sukses procesin e rivlerësimit;
- gjyqtari përmbush kriteret për ngritjen në detyrë;³⁵
- gjyqtari, si dhe familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.
- Vetting-u i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda dhe emërimi i përhershëm i tyre në Gjykatat e Posaçme KKKO

Për emërimin e përhershëm në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjyqtarët aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda do të duhet të konfirmohen në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kalimi i procesit të vetting-ut dhe vendimi i KPK-së janë vendimtarë dhe të detyrueshëm për emërimin e përhershëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pas rreth 8 muajsh (korrik 2018),³⁶ publikoi gjatë muajit prill dy data për seanca dëgjimore të gjyqtarëve të Gjykatës së Krimeve të Rënda të Apelit.³⁷ Aktualisht numri i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda që kanë kaluar procesin e rivlerësimit me vendim të formës së prerë është katër. Nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e përbërë nga 15 gjyqtarë, vetëm 1 prej tyre ka përfunduar procesin e rivlerësimit dhe është konfirmuar në detyrë, aktualisht edhe anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ndërkohë, në rastin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e përbërë nga 12 gjyqtarë, vetëm 2 prej tyre janë konfirmuar në detyrë (1 prej të cilëve si pjesë e listës prioritare) dhe 1 gjyqtar është shkarkuar.

³³ Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Pjesa III, Kreu VIII

³⁴ Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 162/1-5

³⁵ Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 47

³⁶ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kalendari i Seancave Dëgjimore: <http://kpk.al/?tribe-bar-date=2018-07>

³⁷ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kalendari i Seancave Dëgjimore: <http://kpk.al/>

Vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë përcaktuese për emërimin e përhershëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme. Në të njëjtën kohë vendimet në drejtim të konfirmimeve në detyrë apo shkarkimeve të këtyre gjyqtarëve do të jenë të rëndësishme për të përcaktuar dhe plotësuar numrin e nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme. Ashtu sikurse edhe në rastin e vetting-ut të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, raporti i numrit të konfirmimeve në detyrë të subjekteve kundrejt numrit shkarkimeve do të jetë me rëndësi të veçantë për ecurinë e procesit dhe transformimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykata të Posaçme KKKO.

1.5. Cila është përbërja dhe si do të funksionojnë Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

▪ Përbërja

Procesi i ngritjes dhe funksionimit të Gjykatave të Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është parashikuar të realizohet nëpërmjet transformimit të Gjykatave aktuale të Krimeve të Rënda, të përbëra nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Ashtu sikurse Gjykatat e Krimeve të Rënda edhe Gjykatat e Posaçme do të përbëhen nga Gjykata e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar,³⁸ të cilat do të përbëhen respektivisht nga 16 gjyqtarë në shkallën e parë dhe 11 gjyqtarë në apel.³⁹

▪ Organizimi

Të dy shkallët: Gjykatat e Posaçme e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit do të funksionojnë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, duke përfshirë raste kur legjislacioni parashikon të kundërtën.⁴⁰

Struktura organizative e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është parashikuar të jetë e ndërtuar në mënyrë thujtë të njëjtë krahasuar me atë të Gjykatave ekzistuese të Krimeve të Rënda.⁴¹ Në këtë mënyrë, përveç gjyqtarëve, në strukturën e tyre Gjykatat e Posaçme KKKO do të përbëhen nga drejtuesi apo Kryetari i Gjykatës, Kancelari si nëpunësi më i lartë i institucionit dhe njëkohësisht pjesë e strukturës së tyre do të jenë edhe Zyra Administrative dhe Zyra e Gjykatës. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë dhe të Apelit qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Gjykatës së Posaçme.⁴²

▪ Struktura të reja

³⁸ Ligji Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 3/3,b, në vijim: Ligji për pushtetin gjyqësor

³⁹ Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 15/4, pikat c, ç

⁴⁰ Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 24/3

⁴¹ Gjykata e Krimeve të Rënda, Organizimi dhe Struktura: <http://gikr.gov.al/>

⁴² Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 162/6, në vijim: Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

Në ndryshim nga struktura aktuale e Gjykatave të Krimeve të Rënda, për Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë parashikuar dy struktura të reja siç janë *Këshilli i Gjykatës dhe Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës*.

Këshillat e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë parashikuar të krijohen brenda dy javëve pas krijimit të këtyre Gjykatave,⁴³ çka nënkupton faktin që ky proces do të fillojë vetëm me ngritjen e Gjykatave dhe jo përpara. Në të njëjtën kohë duhet theksuar fakti që krijimi i Këshillave të Gjykatave të Posaçme KKKO do të ketë një rol të rëndësishëm në drejtim të konfirmimit në detyrë të të punësuarve pas verifikimit të plotësisht të kushteve të sigurisë siç përshkruhet në pjesën vijuese të kapitullit.⁴⁴ Ligji parashikon që Këshilli i Gjykatës do të përbëhet nga a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës; c) kancelari i gjykatës.⁴⁵

Ndërkohë Mbledhja e Përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës thirret rregullisht dhe kryesohet nga Kryetari i Gjykatës.⁴⁶ Mbledhja të zhvillohet me regjistrim audio dhe mbahet procesverbal për diskutimet e zhvilluara, të cilat ruhen për të paktën dhjetë vjet dhe i vihen në dispozicion gjyqtarëve të gjykatës, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por akses mund t'u jepet edhe personave dhe institucioneve të tjera të interesuara, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale.⁴⁷ Në mbledhjen e përgjithshme të të gjithë gjyqtarëve mund të marrin pjesë si vëzhgues anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor,⁴⁸ por gjithashtu edhe nëpunës civilë gjyqësorë në detyrë ose që kryejnë praktikën profesionale, ose palë të tjera të interesuara, të ftuara nga Kryetari i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve.⁴⁹

- Kompetencat lëndore

Kompetencat parësore lëndore të Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohen në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135/2 të Kushtetutës.⁵⁰

Specifikisht neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale përfshin në juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme kompetencat në vijim:

a. krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;

b. çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c. akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të

⁴³ Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 86/2

⁴⁴ Po aty

⁴⁵ Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 27/2

⁴⁶ Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 29/1

⁴⁷ Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 29/2

⁴⁸ Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 29/3

⁴⁹ Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 29/4

⁵⁰ Ligji Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", Neni 8/1, në vijim: Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;
ç. akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

- Kompetenca të tjera

Përveç kompetencave parësore lëndore, Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të përmendura më lart.⁵¹

- Kompetencat tokësore

Legjislacioni parashikon gjithashtu kompetencat tokësore të Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat do të organizohen dhe funksionojnë për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë.⁵²

⁵¹ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Neni 9/1

⁵² Ligji për pushtetin gjyqësor, Neni 11

II. REFORMIMI I SISTEMIT TË PROKURORISË: PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA NË DREJTIM TË LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE NGRITJA E PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Megjithëse sistemi i prokurorisë në Republikën e Shqipërisë dhe roli i prokurorëve përbën një nga strukturat më të rëndësishme në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ky organ është konsideruar i centralizuar, duke e bërë jo eficient në goditjen e kriminalitetit në tërësi, krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për këtë arsye, Analiza e Sistemit të Drejtësisë vuri në dukje së rezultatet e punës së prokurorisë nuk u përgjigjen sa dhe si duhet sfidave aktuale të kriminalitetit dhe krimit të organizuar dhe korrupsionit në veçanti. Analiza theksoi se kjo gjendje përcaktohet nga shkaqet e mëposhtme:⁵³

- i. modeli organizativ tërësisht i centralizuar dhe hierarkik i prokurorisë, i cili mund të bëhet shkas për ndikimin politik mbi sistemin si dhe për cenimin e pavarësisë së brendshme të prokurorëve;
- ii. roli i kufizuar këshillimor i Këshillit të Prokurorisë në administrimin e çështjeve që lidhen me statusin e prokurorit;
- iii. mangësitë në rregullimin e statusit të prokurorit;
- iv. mungesa e mekanizmave të efektshëm për llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve;
- v. mungesa e mekanizmave të efektshëm për vlerësimin e performancës së prokurorëve. Prokurori i Përgjithshëm, si institucion, aktualisht karakterizohet nga kompetenca të forta hierarkike dhe pushtet të përqendruar mbi çështjet e prokurorëve individualë, ashtu sikurse për çështjet e karrierës, transferimeve dhe disiplinës. Kjo kufizon pavarësinë e brendshme të prokurorisë. Gjithashtu ky pushtet i lartë i përqendruar mbi prokurorët e vendos sistemin në riskun e ndërhyrjeve të jashtme politike.

2.1. Nevoja për ngritjen dhe funksionimin e Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH)

Analiza e Sistemit të Drejtësisë theksoi gjithashtu nevojën për ngritjen e një strukture të specializuar për zbulimin, hetimin dhe gjykimin veprave penale në fushën e korrupsionit. Një strukturë e tillë u konceptua të funksionojë sipas parimeve të qëndrueshmërisë, besueshmërisë dhe qartësisë së kompetencave si dhe e pavarur nga ndikimi i jashtëm i grupeve kriminale apo politike, por edhe e pavarur brenda saj, në mënyrë që një prokuror më i lartë të mos ndikojë ose pushojë çështjet.⁵⁴ Ajo çfarë përbën një nga zhvillimet kryesore të reformës lidhet me faktin që funksionarët do t'i nënshtrohen kontrollit të së shkuarës së tyre dhe duke qenë objekt i monitorimit të vazhdueshëm, sipas modeleve të vendeve të rajonit.

⁵³ Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë (SRSD), faqe 20

⁵⁴ Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë (SRSD), faqe 43

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Bazuar në rekomandimet e Analizës,⁵⁵ ndryshimet kushtetuese parashikuan ngritjen e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si organi kryesor për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësuar akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si edhe Gjykatës së Lartë.⁵⁶

Kompetencat e Prokurorisë së Posaçme përfshijnë shqyrtimin, hetimin dhe ndjekjen penale të çdo vepre penale të parashikuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, të cilat ashtu sikurse edhe në rastin e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar nuk duhet të tejkalojnë kompetencën e përcaktuar në nenin 135, pika 2 e Kushtetutës.⁵⁷

Sipas ligjit, numri minimal i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme është përcaktuar të jetë 10 prokurorë të posaçëm, të cilët do të zgjedhin ndërmjet tyre kryetarin e Prokurorisë.⁵⁸ Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi përgjegjës për zgjedhjen e prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme, emërimi i të cilëve duhet të përfundonte brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (19 dhjetor 2018).⁵⁹ Gjithashtu, përveç kancelarit, i cili është nëpunësi më i lartë i institucionit, Prokuroria e Posaçme përbëhet edhe nga sektorë mbështetës:⁶⁰

- Sektori i Dokumentacionit;
- Sektori i Ekspertizës;
- Sektori i Hetimit Financiar;
- Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetimet e Përbashkëta;
- Sektori për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm;
- Koordinatorin për Marrëdhënien me Mediat

Të gjithë punonjësit e sektorëve të mësipërm, por edhe punonjës të tjerë që do të jenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme do të duhet të plotësojnë gjithashtu kushtet e sigurisë përpara konfirmimit të tyre në pozicionet respektive. Kushtet e sigurisë përfshijnë:⁶¹

1. kontrollin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës;
2. dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake; si dhe
3. dhënien e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH)

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 4/1

⁵⁷ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 8/1

⁵⁸ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 11/1

Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 148/dh, pika 2

⁵⁹ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 179/8

⁶⁰ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Nenet 17-25

⁶¹ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 6/1

Fillimi i procedurave për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme, përbën një proces të rëndësishëm jo vetëm në drejtim të funksionimit të një prej organeve më të rëndësishme të hetimit për veprat e korrupsionit dhe krimin të organizuar, por gjithashtu thelbësor edhe në drejtim të ngritjes së një tjetër strukture mbështetëse pranë Prokurorisë siç është Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH).

BKH do të jetë një strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, e cila do të funksionojë në drejtimin e Prokurorisë së Posaçme⁶² dhe do të përbëhet nga drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit dhe punonjësit e administratës. Ajo ka gjithashtu në përbërje të saj shërbime të Policisë Gjyqësore, të përbëra nga oficerë të Policisë Gjyqësore, nga Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera përkatëse, të cilët janë nën drejtimin administrativ të Zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nën vartësi procedurale hetimore të Prokurorisë së Posaçme.⁶³

Prokuroria e Posaçme do të ketë rol kryesor në zgjedhjen e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili do të jetë përgjegjës për funksionimin e kësaj strukture. Megjithatë Drejtori i BKH-së do të emërohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, një Komision i përbërë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë të posaçëm (me më shumë vite eskperiençë punë si prokuror) pas një procesi rekrutimi të hapur dhe transparent do të rekomandojnë një kandidat për Drejtor të BKH-së.⁶⁴

Drejtori i BKH-së do të mbikqyret nga një komision i përbërë prej tre prokurorësh të Prokurorisë së Posaçme, njëri prej të cilëve është drejtuesi i saj dhe dy të tjerët, të cilët do të zgjidhen çdo vit me short. Drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përzgjedh nga radhët e hetuesve një zëvendësdrejtor.⁶⁵

Ashtu sikurse edhe në rastin e punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, kandidatët për punonjës në Byronë Kombëtare të Hetimit, përfshirë drejtorin, zëvendësdrejtorin, hetuesit, punonjësit dhe oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore do të duhet të përmbushin më parë kushtet e sigurisë. Mos përmbushja e kushteve të sigurisë e bën të pamundur ushtrimin e detyrave të tyre si pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit.⁶⁶

2.2. Konstituimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP)

- Zgjedhja e anëtarëve prokurorë të KLP-së

Krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), sikurse edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, shënuan një nga zhvillimet më kryesore të zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë. Ngritja e këtyre organeve përbën një hap të rëndësishëm, pasi këto institucione kanë një rol thelbësor në menaxhimin e sistemit të prokurorisë dhe atij gjyqësor.

Fillimisht për të qenë pjesë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë aplikuan 18 prokurorë, nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe prokuroria e Tiranës si edhe prokurorë të Prokurorisë të Krimeve të Rënda. Të gjithë këta prokurorë, kandidatë për në Këshillin e Lartë të Prokurorisë u përfshinë në listën prioritare të rivlerësimit nga Komisioni

⁶² Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 31/1

⁶³ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 31/3

⁶⁴ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 33/2

⁶⁵ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 33/5-6

⁶⁶ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Neni 6/1

i Pavarur i Kualifikimit (KPK).⁶⁷ Procesi i rivlerësimit të 18 prokurorëve u zhvillua gjatë periudhës prill-nëntor 2018, duke zgjatur rreth 7 muaj, përfshirë edhe rastet e mos plotësimit të vendeve vakante dhe rishpalljen e thirrjeve.⁶⁸

Nga 19 aplikime në total, 10 prokurorë u konfirmuan në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërkohë që 9 prej tyre nuk arritën të kalonin procesin e rivlerësimit. Rreth 45% e kandidatëve për në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të cilët kaluan vetting-un u vlerësuan me nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, ndërkohë që rreth 50% apo gjysma e vendimeve për 10 subjektet e konfirmuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit u ankuan në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA).⁶⁹

Me përfundimin e vetting-ut për të gjitha subjektet kandidatë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e zhvilluar në 11 dhjetor 2018,⁷⁰ zgjodhi nëpërmjet votimit 6 anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,⁷¹ të cilët ju bashkuan 5 anëtarëve jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë në 8 shkurt të vitit 2018.⁷² Mbledhja e parë e Këshillit, e cila solli edhe konstituimin e këtij organi u zhvillua në datën 19 dhjetor 2018.⁷³ Gjatë kësaj seance të parë, Këshilli zgjodhi kryetarin e tij dhe zv/kryetarin si edhe përcaktoi mandatet e secilit anëtar të këtij institucioni.

- Kapacitetet logjistike, administrative dhe njerëzore të KLP-së

Marrja e masave në drejtim të aspekteve logjistike, administrative dhe njerëzore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është një nga aspektet kryesore për mbarvajtjen e aktivitetit dhe përmbushjen e kompetencave të institucionit. Në drejtim të realizimit të këtyre objektivave, një nga hapat e parë të ndërmarrë ka qenë planifikimi për staf administrativ dhe buxheti i institucionit për vitin 2019. Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjatë seancës plenare nr.6 ka vlerësuar bazuar në ngarkesën e punës dhe kompetencat në drejtim të vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për prokurorë të posaçëm, përcaktimin e një stafi prej 75 punonjësish duke përfshirë edhe vetë numrin e anëtarëve të Këshillit.⁷⁴ Shkresa zyrtare dhe buxheti i janë dërguar Kuvendit të Shqipërisë në fund të muajit janar 2019,⁷⁵ ndërkohë që pas shqyrtimit dhe miratimit të Vendimit “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë të

⁶⁷ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Shorti për subjektet e listës së përparësisë:

<http://kpk.al/2017/12/12/njoftim/>

⁶⁸ Prokuroria e Përgjithshme, “Thirrje për paraqitjen e shprehjes së interesit për kandidatë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë – Prokurorëve pranë Gjykatave të Apelit”, 12.10.2018:

http://www.pp.gov.al/web/Rezultatet_e_Kerkimit_237_1.php?search=thirrje#.XJpL1VKgdU

⁶⁹ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, SPAK Monitor – Buletin Informativ Nr.2, fq. 5-6

http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2018/12/newsletter_spak2_03.pdf

Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP), Ankime: <http://ikp.al/ankime/>

⁷⁰ Procesverbal i procesit të votimit nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë: http://www.pp.gov.al/web/procesverbali_1428.pdf

⁷¹ Vendim për rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve: http://www.pp.gov.al/web/vendim_1429.pdf

⁷² Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 19/2018 Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas Ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”:

<http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2019/VENDIM%20KUVENDI%20nr.%2019-2018,%20date%208.2.2018.pdf>

⁷³ Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Krijohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë, 11 dhjetor 2018:

<http://klp.al/index.php/2018/12/22/seanca-plenare-1/>

⁷⁴ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Seanca Plenare Nr. 6, dt. 22 shkurt 2019:

<http://klp.al/index.php/2019/02/22/seanca-plenare-nr-6/>

⁷⁵ Kuvendi i Shqipërisë, Projektvendim “Për miratimin e strukturës organizative të KLP”:

<http://www.parlament.al/Projekte/PPPDetaile/461>

Prokurorisë” nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës,⁷⁶ Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancën plenare të datës 26 shkurt organikën dhe buxhetin e institucionit.⁷⁷

Në funksion të ushtrimit të kompetencave të parashikuara për tu realizuar gjatë fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit, një aspekt teknik i rëndësishëm ka qenë përgatitja e faqes zyrtare të institucionit.⁷⁸ Ndër të tjera, faqja zyrtare në internet ka qenë një instrument kryesor në funksion të publikimit të njoftimeve për shpalljen e vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme si edhe shpalljen e pozicionit për Prokuror të Përgjithshëm. Këshilli ka miratuar gjithashtu edhe Programin e Transparencës⁷⁹ si edhe ngritjen e 4 komisioneve të përhershme pranë Këshillit, specifikisht:⁸⁰

- Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit
- Komisioni Disiplinor
- Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
- Komisioni i Etikës

Gjatë muajit maj 2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka publikuar gjithashtu shpalljen për pozicionin vakant të sekretarit të përgjithshëm të institucionit,⁸¹ proces i cili është parashikuar të përfundojë gjatë muajit korrik 2019.⁸²

Ndërkohë një nga problematikat ende të pazgjidhura për Këshillin e Lartë të Prokurorisë mbetet sigurimi i ambienteve të përhershme të punës. KLP në fillim të veprimtarisë ka përdorur disa zyra të përkohshme në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, ndërkohë mbledhjet janë zhvilluar në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor (ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë). Sigurimi përfundimtar i ambienteve të punës së Këshillit mbetet një çështje prioritare duke patur parasysh që ky organ po kryen një sërë detyrash të rëndësishme, ndër të cilat përfshihen zbatimi i hapave ligjorë në drejtim të vlerësimit dhe përzgjedhjes së prokurorëve kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme.

Marrja e masave në këtë drejtim mbetet një përgjegjësi e Këshillit të Ministrave, në mënyrë të veçantë vonesat në alokimin e buxhetit dhe gjetja e godinës për zhvillimin e aktivitetit të KLP-së duket se do të përbëjnë një pengesë serioze edhe gjatë muajve në vijim kur pritet të përfundojnë disa nga detyrat më të rëndësishme të KLP-së.⁸³

⁷⁶ Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut miratoi numrin e punonjësve për KLGJ dhe KLP, për vitin 2019: <http://www.parlament.al/News/Index/7191>

⁷⁷ Kuvendi i Shqipërisë, Seanca Plenare, e martë 26 shkurt 2019: <http://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=3596>

⁷⁸ Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP): www.klp.al
⁷⁹ <http://klp.al/index.php/programi-i-transparences/>

⁸⁰ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Vendim Nr. 6, dt.26.12.2018 “Për krijimin e komisioneve të përhershme pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”: <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/03/Nr.6-Dat%C3%AB-26.12.2018-.pdf>

⁸¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall hapjen e procedurës së rekrutimit për pozicionin Sekretar i Përgjithshëm në KLP: <http://klp.al/index.php/2019/05/28/keshilli-i-larte-i-prokurorise-shpall-hapjen-e-procedures-se-rekrutimit-per-pozicionin-sekretar-i-pergjithshem-ne-klp/>

⁸² Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Shpallje për pranim të drejtëpërdrejtë, në kategorinë e nivelit të lartë drejtues në Këshillin e Lartë të Prokurorisë: <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/05/SHPALLJE-P%C3%8BR-PRANIM-T%C3%8B-DREJTP%C3%8BDREJT%C3%8B-N%C3%8B-KATEGORINE-E-NIVELIT-TE-LARTE-DREJTUES-NE-KLP.pdf>

⁸³ Tempora - Gent Ibrahim: Pa buxhet dhe pa zyra, vështirë të funksionojmë: <https://www.youtube.com/watch?v=a5-C5rESc8>

2.3. Kompetencat e KLP-së në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale për prokurororët e posaçëm dhe nëpunësit civilë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi, i cili luan një rol kyç në vlerësimin, përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme. Megjithëse të parashikuar për tu emëruar brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit,⁸⁴ si rezultat i kohës së konstituimit të Këshillit dhe procedurave ligjore respektive, KLP vlerësoi se emërimi i prokurorëve të posaçëm do të marrë një kohë më të gjatë.⁸⁵

Pas konstituimit të Këshillit filloi zbatimin e ushtrimit të kompetencave të këtij organi në drejtim të shpalljes së aplikimeve për prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme. Rreth 3 javë nga krijimi i tij, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpalli në datën 7 janar 2019 thirrjen për shprehjen e interesit për kandidatë për prokurorë për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme.⁸⁶ Afati i thirrjes parashikoi një periudhë prej 30 ditësh kalendarike deri në datën 6 shkurt 2019. Kriteret bazë ligjore të vendosura për kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, ndër të tjera përfshinin:

- Eksperiencë në funksionin e prokurorit për jo më pak se 10 vjet;
- Mungesën e masave disiplinore në fuqi;
- Dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;
- Sigurimin e pëlqimit të anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Me përfundimin e këtij afati, 15 kandidatë për prokurorë aplikuan dhe shprehën interesin e tyre për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Megjithatë, si rezultat i nevojës për të nxitur aplikimin e prokurorëve të tjerë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi në seancën plenare nr.5 shtyrjen e afatit deri në datën 21 shkurt.⁸⁷ Lista përfundimtare e kandidatëve, të cilët shprehën interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, u përmyll me aplikimin e 28 kandidatëve në total.⁸⁸

Pjesa më e madhe e kandidatëve, i përkasin prokurorëve aktualë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Këto të fundit për shkak të përvojës dhe specifikave profesionale janë konsideruar kandidatët më të mundshëm për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme. Megjithatë një numër i konsiderueshëm kandidatësh aplikuan nga prokuroria e Tiranës si edhe prokuroritë e rrethave të tjera gjyqësore. Ndërkohë 3 kandidatë të përfshirë në procesin e aplikimeve, ishin subjekte jashtë sistemit të prokurorisë.

Me mbylljen e aplikimeve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë filloi ushtrimin e kompetencave në drejtim të procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për prokurorëve në

⁸⁴ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 179/dh, pika 8

⁸⁵ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Seanca Plenare Nr. 8: <http://klp.al/index.php/2019/03/19/seanca-plenare-nr-8/>

⁸⁶ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Vendim Nr. 10/1, datë 07 janar 2019 "Për shpalljen e vendeve vakante për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar": <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/03/Nr.10.1-Dat%C3%AB-07.01.2019-.pdf>

<http://klp.al/wp-content/uploads/2019/01/Thirrje-per-SPAK-2.pdf>

⁸⁷ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Seanca Plenare Nr. 5: <http://klp.al/index.php/2019/02/06/seanca-plenare-nr-5/>

⁸⁸ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Lista e aplikimeve për SPAK: <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/02/lista-e-aplikimeve-per-SPAK.pdf>

Prokurorinë e Posaçme. Në këtë mënyrë, Këshilli hartoi Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, e cila përcakton në mënyrë të detajuar procedurat, afatet e vlerësimit dhe përzgjedhjes së prokurorëve kandidatë në Prokurorinë e Posaçme.

- Rregullore për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për prokurorë të posaçëm

Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” e miratuar në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19 mars,⁸⁹ hyri në fuqi në datën 29 mars me botimin në fletoren zyrtare nr 44.⁹⁰ Qëllimi kryesor i rregullores është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për ngritjen në detyrë të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, bazuar në një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës, me synim krijimin e Prokurorisë së Posaçme të aftë për të ushtruar funksionet e saj në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe efektive.⁹¹

Rregullorja përcakton fillimisht kushtet ligjore, të cilat duhet të plotësohen nga kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, të cilat përfshijnë kërkesat si më poshtë për kandidatët:⁹²

- Të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- Të ketë ushtruar funksionin si prokuror për jo më pak se 10 (dhjetë) vjet, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar;
- Të mos ketë masa disiplinore;
- Të përmbushë kushtet e sigurisë;
- Të ketë kaluar me vendim të formës së prerë procesin e rivlerësimit.

Me qëllim vlerësimin paraprak të kandidatëve për prokurorë të posaçëm, Rregullorja parashikon krijimin e një Komisioni të Posaçëm tranzitor, të përbërë nga 5 anëtarë të Këshillit, prej të cilëve 3 anëtarë prokurorë dhe 2 anëtarë jo-prokurorë.⁹³ Anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë *ex officio* anëtarë të Komisionit të Posaçëm ndërsa anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Vepimtarisë Etike dhe Profesionale përjashtohen *ex officio* nga pjesëmarrja në Komisionin e Posaçëm. Dy anëtarët e tjerë të Komisionit të Posaçëm, njëri prej të cilëve anëtar prokuror dhe tjetri anëtar jo prokuror, zgjidhen me short nga pjesa e mbetur e anëtarëve të Këshillit.⁹⁴ Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjedh gjithashtu kryetarin e Komisionit të Posaçëm, i cili relatton para Këshillit rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve.⁹⁵

⁸⁹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Seanca Plenare Nr. 8: <http://klp.al/index.php/2019/03/19/seanca-plenare-nr-8/>

⁹⁰ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Vendim Nr. 51, datë 19.3.2019 për Miratimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2019/PDF-2019/44-2019.pdf

⁹¹ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 1

⁹² Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 4

⁹³ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 11/1-2

⁹⁴ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 11/2

⁹⁵ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 11/3

Fillimisht Komisioni i Posaçëm shqyrton nëse kandidatët plotësojnë kushtet ligjore më lart dhe i raporton Këshillit në një mbledhje sa më të shpejtë kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kushtet. Ndërkohë, Komisioni përgatit një listë tjetër me emrat e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet ligjore. Për këto të fundit, komisioni vlerëson statusin e rivlerësimit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Pas kësaj Këshilli i përcjell Komisionit për rivlerësim me përparësi, emrat e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet ligjore dhe nuk i janë nënshtruar ende procesit të rivlerësimit, si dhe Komisionit të Posaçëm të Apelimit emrat e kandidatëve për të cilët, në kuadër të procesit të rivlerësimit, është ushtruar ankim pranë këtij institucioni duke kërkuar kryerjen/përfundimin me përparësi të procesit të rivlerësimit.⁹⁶

Në funksion të zbatimit të parashikimeve më lart, dhe të respektimit të afateve ligjore, Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas zgjedhjes me short të 2 anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit të Posaçëm,⁹⁷ vendosi në axhendën e seancës plenare nr. 11 prezantimin e raportit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për SPAK, pas vlerësimit paraprak të plotësimin të kushteve ligjore për ngritjen në detyrë nga kandidatët që kanë shprehur interes dhe miratimin e listës me emrat e kandidatëve që kanë shprehur interes për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, të cilët plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë pas vlerësimit paraprak.⁹⁸

Nga 28 kandidatë të cilët shprehën interesin për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, 25 prej tyre përmbushnin kushtet ligjore dhe u kualifikuan për të vazhduar garën e mëtejshme për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.⁹⁹

25 kandidatët, të cilët do të vazhdojnë garën për prokurorë pranë Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, do të nënshtrohen një procesi vlerësimi nga Komisioni i Posaçëm. Vlerësimi në Komisionin e Posaçëm do të realizohet mbi bazën e dy kriterëve kryesore, ndërkohë që çdonjëri prej tyre do të ketë shkallën e vlerësimit sipas standardeve të përcaktuara në Rregullore: (Aneks V & VI)

1. Kriteri i Vlerësimit të Performancës (dy vitet e fundit)
2. Kriteret e posaçme etike dhe profesionale:
 - Aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim
 - Vendosmëria e treguar në përbalimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti

Pas përfundimit të vlerësimit të kandidatëve, i cili i parashikuar të përfundojë në fillim të muajit qershor 2019,¹⁰⁰ Komisioni do të dërgojë Këshilli një raport përfundimtar, dhe pas kësaj Këshilli do të realizojë intervistat me kandidatët për prokurorë, gjatë të cilave do të marrin

⁹⁶ Rregullore "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", Neni 12

⁹⁷ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Seanca Plenare Nr. 10: <http://klp.al/index.php/2019/04/01/seanca-plenare-nr-10/>

⁹⁸ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Seanca Plenare Nr. 11: <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/04/Axhenda-e-mbledhjes-05.04.2019-1.pdf>

⁹⁹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Vendim Nr. 57, datë 05.04.2019 "Për miratimin e listës me emrat e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të cilët plotësojnë kushtet ligjore pas vlerësimit paraprak": <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/04/Nr.57-Dat%C3%AB-05.04.2019.pdf>

¹⁰⁰ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Seanca Plenare Nr. 11: <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/04/Axhenda-e-mbledhjes-05.04.2019-1.pdf>

pjesë dhe drejtojnë pyetje edhe përfaqësuesit e misioneve EURALIUS dhe OPDAT.¹⁰¹ Pas përfundimit të këtyre hapave, Këshilli është organi, i cili bën vlerësimin përfundimtar dhe renditjen e kandidatëve të përzgjedhur.

2.4. Krijimi i Prokurorisë së Posaçme dhe zgjedhja e drejtuesit të saj

Përfundimi i procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë i kandidatëve prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, është një hap i rëndësishëm, i cili i shërben në të njëjtën kohë edhe vetë krijimit të këtij institucioni. Për këtë arsye Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” ka përcaktuar në dispozitat e saj edhe hapat ligjore në lidhje me krijimin e Prokurorisë së Posaçme.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është parashikuar të mblidhet për të vendosur krijimin e Prokurorisë së Posaçme sapo të arrihet numri i nevojshëm i prokurorëve të konfirmuar për ngritje në detyrë si prokurorë të posaçëm, të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.¹⁰² Ato prokurorë, të cilët nuk arrijnë të kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit nuk kualifikohen për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, ndërkohë që Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të rihapë thirrjen për aplikime në rast se ka nevojë për më tepër anëtarë edhe pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme.¹⁰³

Një nga hapat më të rëndësishëm që parashikon Rregullorja është koordinimi i punës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor për të siguruar lehtësi në krijimin e Gjykatave së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por edhe Prokurorisë së Posaçme.¹⁰⁴ Siç është përmendur edhe më herët në raport, ngritja e harmonizuar e institucioneve të hetimit dhe gjyqimit për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është e rëndësishme dhe në funksion të ecurisë normale të procesit dhe garantimit të të drejtave të të akuzuarve.

Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Rregullorja parashikon edhe procesin e zgjedhjes së drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili zgjidhet ndërmjet prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme.¹⁰⁵ Rregullorja parashikon gjithashtu standardet e vlerësimit dhe procedurën për zgjedhjen e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme,¹⁰⁶ i cili zgjidhet me votat e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ndërmjet kandidatëve të cilët kanë shprehur interes për këtë pozicion. Krijimi i Prokurorisë së Posaçme dhe zgjedhja e drejtuesit të këtij institucioni përbën një komponent kyç të reformës sa i përket funksionimit të një prej institucioneve më kryesore të hetimit në vend.

¹⁰¹ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 23

¹⁰² Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 17/1

¹⁰³ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 17/5

¹⁰⁴ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 17/2

¹⁰⁵ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Neni 18

¹⁰⁶ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Nenet 19-20

III. ROLI I OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT (ONM) NË ZBATIMIN E REFORMËS NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Institucionet e sistemit gjyqësor në Shqipëri janë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga misionet ndërkombëtare të EURALIUS dhe OPDAT. Në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë dhe riorganizimit të thujtë të gjitha organeve kryesore ekzistuese në vend, ndryshimet kushtetuese të miratuara në korrik 2016 parashikuan edhe praninë e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), i udhëhequr nga Komisioni Evropian dhe i dizenuar për të mbështetur kryesisht procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mikqyrjes së gjithë procesit.

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit përbëhet nga vëzhgues ndërkombëtarë, të emëruar nga rradhët e gjyqtarëve apo prokurorëve me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në sistemin e drejtësisë së vendeve të tyre përkatëse. Në kuadër të Operacionit Ndërkombëtar të monitorimit në Shqipëri u emëruan 8 ekspertë ndërkombëtarë, profilet e të cilëve u publikuan në faqen zyrtare të Delegacionit të BE në Shqipëri.¹⁰⁷ Në përbërje të këtij grupi përfshihen 1 nga Belgjika, 1 nga Italia, 1 nga Bullgaria, 1 nga Kroacia, 2 nga Holanda, 1 nga Suedia dhe 1 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Vëzhguesit dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë qenë të pranishëm në të gjitha seancat dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe ndërkohë kanë dorëzuar rekomandimet përkatëse në Institutin e Komisionerit Publik për apelimin e vendimeve të 7 subjekteve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.¹⁰⁸

	Subjekti	Vendimi i KPK
Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) → Rekomandime	1. Adnan Kosova	Vendimin KPK, nr. 90, datë 20.12.2018
	2. Besnik Cani	Vendimin KPK, nr. 84, datë 27.11.2018
	3. Artur Malaj	Vendimin KPK, nr. 62, datë 3.8.2018
	4. Gentjan Osmani	Vendimin KPK, nr. 61, datë 2.8.2018
	5. Gentian Medja	Vendimin KPK, nr. 60, datë 1.8.2018
	6. Xhezair Zaganjori	Vendimin KPK, nr. 46, datë 24.7.2018
	7. Bashkim Dedja	Vendimin KPK, nr. 24, datë 13.6.2018

Megjithëse roli i ONM-së mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të mbikqyrjes dhe monitorimit të zhvillimit të reformës në sistemin e drejtësisë, nevoja për një koordinim më aktiv në kuadër të aktivitetit të këtij Misioni mbetet mjaft e rëndësishme dhe e mirëpritur edhe nga publiku i gjerë. Ky i fundit e konsideron shpesh rolin e përfaqësuesve ndërkombëtarë në vend si një garanci për zbatimin sa më eficient të zbatimit të reformës në drejtësi dhe ngritjes së institucioneve të reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

¹⁰⁷ Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri: Profilet e ekipit të ekspertëve afatshkurtër, https://eeas.europa.eu/delegations/albania/20215/node/20215_sq

¹⁰⁸ Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP): Rekomandime nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM), <http://ikp.al/rekomandime/>

IV. ZYRA PËR NDALIMIN E KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR (USKOK), KROACI DHE PROGRESI NË LUFTËN NDAJ KORRUPSIONIT

Krijimi dhe funksionimi i Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri është ndërtuar bazuar në një model të ngjashëm me Zyrën për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Kroaci (USKOK), e cila u themelua në vitin 2001 si pjesë e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe si përgjigje ndaj niveleve të larta të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat u shfaqën në mënyrë të veçantë pas përfundimit të luftës civile në vend dhe nevojës për ristrukturimin dhe zhvillimin e ekonomisë.

Për këtë arsye, Kroacia ndërmorri gjatë viteve 2000-2012 një sërë masash institucionale dhe ligjore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat u ndanë në 3 faza kryesore.¹⁰⁹ Megjithatë, krijimi i USKOK në Kroaci si edhe ngritja e Këshillit Kombëtar për Luftën kundër Korrupsionit, ishin ndër masat e para të ndërmarra në kuadër të angazhimit politik në vend që në fillim të viteve 2000, me qëllim luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Megjithëse krijimi USKOK, u konsideruan ndër arritjet më të rëndësishme të Kroacisë në luftën kundër korrupsionit, fillimi i funksionimit eficient të këtij organi të specializuar, u përball me sfida specifike. Ligji për Zyrën për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (USKOK) hyri në fuqi në tetor të vitit 2001 dhe USKOK filloi funksionimin në dhjetor të vitit 2001, pas zgjedhjes së drejtuesit të këtij institucioni.¹¹⁰ Megjithatë deri në fillimin e vitit 2006 vetëm Departamenti i Prokurorit ishte plotësisht funksional. Vetëm gjatë vitit 2006, rreth 5 vjet pas krijimit të Zyrës, u bënë funksionale të katër Departamentet e Zyrës, ku përfshiheshin Departamenti i Prokurorit, Departamenti i Antikorrupsionit dhe Marrëdhënieve me Publikun, Departamenti i Hetimit dhe Dokumentacionit si edhe Departamenti për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta.¹¹¹

Megjithatë edhe pas këtyre zhvillimeve, gjatë viteve në vijim USKOK është ndeshur me sfida të cilat lidhen me pjesëmarrjen e pamjaftueshme të institucioneve të tjera shtetërore në zbulimin dhe raportimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar; mungesën e përvojës së prokurorëve të USKOK-ut në përdorimin e mjeteve ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si edhe zhvillimin e pamjaftueshëm të aktiviteteve të marrëdhënieve publike të USKOK-ut në promovimin e punës dhe arritjeve të këtij institucioni.¹¹²

Gjithashtu, si rezultat i aspekteve financiare dhe mungesës së prokurorëve të trajnuar dhe specializur, USKOK do të duhej një kohë relativisht e gjatë për të qenë tërësisht funksional dhe ushtruar në mënyrë eficiente kompetencat e parashikuara, të cilat u fokusuan kryesisht në

¹⁰⁹ Speeding up Moldova's EU integration process through progress in the field of anticorruption. Lessons learned from Croatia; Policy Paper 32, July 2014, pg. 6

¹¹⁰ Gabriel Kuris. "Cleaning House: Croatia Mops Up High-Level Corruption, 2005–2012", Innovations for Successful Societies. Princeton University. 2013

¹¹¹ At its 9th Plenary Meeting (May 2002) GRECO decided to extend the First Evaluation Round until 17 May 2002.

¹¹² Po aty

hetimin dhe ndjekjen penale, megjithëse përgjegjësitë e kësaj Zyre përfshinin edhe parandalimin e korrupsionit.

Me kalimin e kohës, USKOK do të luante një rol më aktiv në mënyrë të vecantë në hetimin e rasteve të korrupsionit në nivele të larta. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, kompetencat në drejtim të hetimit të USKOK janë përforcuar sa i përket kompetencave dhe masave hetimore. Krijimi i 4 dhomave speciale për të trajtuar rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit si edhe krijimi i Zyrës Kombëtare të Policisë për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PNUSKOK) do të luanin një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e USKOK, si një organ i specializuar që vepron në bashkërendim me zyrën e prokurorit kompetent duke krijuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe multidisiplinare në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë.¹¹³

¹¹³ Po aty

V. REKOMANDIME: MBËSHTETJA NË DREJTIM TË INSTITUCIONEVE TË REJA KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Megjithëse ngritja dhe funksionimi i Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK) përbën një nga objektivat kryesore të reformës në sistemin e drejtësisë, fillimi i funksionimit të këtyre institucioneve, ashtu si edhe praktika e strukturave të ngjashme në vende të rajonit, do të marrë kohën e nevojshme sa i përket ushtrimit të plotë dhe funksional të kompetencave.

Deri në ngritjen e këtyre organeve, do të duhet gjithashtu që disa procese të koordinohen ndërmjet organeve kryesore qeverisëse. Në këtë mënyrë, ndërkohë që Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, e miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, parashikon afate të përcaktuara në drejtim të vlerësimit paraprak dhe përzgjedhjes së kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, (proces i parashikuar të përfundojë brenda muajit qershor 2019), në rastin e emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ende nuk ka afate të ngjashme të përcaktuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Pavarësisht se emërimi i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të përfundonte brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor (brenda muajit shkurt 2019), KLGJ nuk është shprehur ende mbi këtë proces. Edhe pse në mbledhjen e datës 27 dhjetor 2018 Këshilli i Lartë Gjyqësor filloi procedurat për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave për Krimet e Rënda në Gjykatat e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, ende nuk ka një informacion zyrtar mbi numrin e gjyqtarëve, të cilët kanë pranuar kërkesat ligjore për kufizimin e privatësisë duke u emëruar përkohësisht në Gjykatat e Posaçme. Megjithëse ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2017 parashikojnë ekzistencën e Gjykatave të Krimeve të Rënda deri në ngritjen e Gjykatave të Posaçme (në ndryshim nga afati i mëparshëm 300 ditore nga hyrja në fuqi e Ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), mungojnë afatet e qarta apo të përafërta kohore mbi ecurinë dhe kohën që do të marrë ky proces.

Nga ana tjetër, një fazë po kaq e rëndësishme do të jetë rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve kandidatë në Gjykatat e Posaçme dhe Prokurorinë e Posaçme. Megjithëse Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë filluar tashmë zbatimin e kompetencave në drejtim të emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve apo vlerësimit dhe përzgjedhjes së prokurorëve, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të jetë përcaktues për emërimin e tyre në organet e reja të gjyqimit dhe hetimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Pa vendimin e formës së prerë të KPK-së për konfirmimin në detyrë të kandidatëve nuk mund të realizohet emërimi i tyre i përhershëm në këto organe.

Duke ju referuar rezultateve të deritanishme në lidhje me numrin e ulët të konfirmimeve, vonesave të krijuara si rezultat i rishpalljes së thirrjeve, vonesave në verifikimin e kushteve të sigurisë apo numrin relativisht të lartë të ankimimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, procesi i rivlerësimit mund të paraqesë sfida të ngjashme edhe për gjyqtarët dhe prokurorët e posaçëm. Ndërkohë ashtu sikurse edhe në rastin vetting-ut të kandidatëve gjyqtarë dhe

prokurorë në organet e reja të drejtësisë, ritmet dhe përshpejtimi i këtij procesi mbeten thelbësore për të shmangur vonesa në ngritjen e institucioneve.

Ndërkohë që në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcakton kërkesën ndaj Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për rivlerësimin me përparësi të kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, në rastin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk ka një kërkesë të tillë në drejtim të rivlerësimit me përparësi për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda. Pavarësisht se gjyqtarëve të këtyre gjykatave iu është krijuar mundësia e kalimit dhe emërimit në mënyrë provizore në Gjykatat e Posaçme, emërimi i përhershëm i tyre është i domosdoshëm jo vetëm për mbarvajtjen afatgjatë të institucioneve të gjyqimit, por edhe në harmonizimin e veprimtarisë së tyre me organet e reja të hetimit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Megjithëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar tashmë procedurat e rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda si edhe kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, për shumë pak prej tyre ka përfunduar procesi me vendim të formës së prerë. Vetëm tre gjyqtarë të Krimeve të Rënda dhe 5 prokurorë nga 27 kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme janë konfirmuar në detyrë. Ndërkohë në datën 2 prill 2019 KPK përfundoi seancën dëgjimore me kryetarin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, për të cilin pritet të jepet së shpejti vendimi.

Në këtë mënyrë, roli i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të jetë i rëndësishëm për të realizuar në kohë dhe pa vonesa rivlerësimin e kandidatëve për organet e reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Mundësia e numrit të ulët të konfirmimeve në detyrë e bën edhe më të nevojshëm avancimin e këtij procesi për ti paraprirë përsëritjes së procedurave në drejtim të plotësimit të numrit të nevojshëm me gjyqtarë dhe prokurorë në këto organe.

Gjithashtu me po kaq rëndësi mbetet edhe koordinimi ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të bërë të mundur bashkërendimin e afateve kohore në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme.

Krijimi i Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të ndodhë në të njëjtën kohë me krijimin e Prokurorisë së Posaçme në mënyrë që të sigurohet vijimësia e shqyrtimit të çështjeve si edhe të respektohen të drejtat dhe garancitë e personave për një gjykim të drejtë.

Së fundmi dhe po me kaq rëndësi mbetet fakti që mbështetja ndaj institucioneve të reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të jetë po kaq thelbësore për funksionimin e plotë dhe eficient të tyre. Ashtu si edhe në rastin e USKOK në Kroaci, nevoja për transparencë, koordinim dhe fuqizim në drejtim të aspekteve logjistike, administrative dhe institucionale do të përcaktojë rezultat e para në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në vend.

ANEKS I – RENDITJA E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË INDEKSIN E PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT TË TRANSPARANCY INTERNATIONAL

	Shqipëria		Bosnja dhe Hercegovina		Kroacia		Maqedonia e Veriut		Mali i Zi		Serbia	
	Pikët	Renditja	Pikët	Renditja	Pikët	Renditja	Pikët	Renditja	Pikët	Renditja	Pikët	Renditja
2018	36	99	38	89	48	60	37	93	45	67	39	87
2017	38	91	38	91	49	57	35	107	46	64	41	77
2016	39	83	39	83	49	55	37	90	45	64	42	72
2015	36	88	38	76	51	50	42	66	44	61	40	71
2014	33	110	39	80	48	61	45	64	42	76	41	78
2013	31	116	42	72	48	57	44	67	44	67	42	72
2012	33	113	42	72	46	62	43	69	41	75	39	80
2011	3.1	95	3.2	91	4.0	66	3.9	69	4.0	66	3.3	86
2010	3.3	87	3.2	91	4.1	62	4.1	62	3.7	69	3.5	78
2009	3.2	95	3.0	99	4.1	66	3.8	71	3.9	69	3.5	83
2008	3.4	85	3.2	92	4.4	62	3.6	72	3.4	85	3.4	85
2007	2.9	105	3.3	84	4.1	64	3.3	84	3.3	84	3.4	79
2006	2.6	111	2.9	93	3.4	69	2.7	105	-	-	3.0	90
2005	2.4	126	2.9	88	3.4	70	2.7	103	-	-	2.8	97
2004	2.5	108	3.1	82	3.5	67	2.7	97	-	-	2.7	97
2003	2.5	92	3.3	70	3.7	59	2.3	106	-	-	2.3	106
2002	2.5	81	-	-	3.8	51	-	-	-	-	-	-
2001	-	-	-	-	3.9	47	-	-	-	-	-	-
2000	-	-	-	-	3.7	51	-	-	-	-	-	-
1999	2.3	84	-	-	2.7	74	3.3	63	-	-	-	-

* Burimi, Transparency International, Corruption Perceptions Index: <https://www.transparency.org/research/cpi/overview>

ANEKS II – PAKETA E PROJEKTLIGJEVE TË REFORMËS NË DREJTËSI

Nr.	Projektligjet e Paketës së Reformës në Drejtësi	Seancë plenare	Vota pro
1.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, të ndryshuar	30 mars 2017	88
2.	Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”	30 mars 2017	88
3.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”	30 mars 2017	88
4.	Projektligji “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”	30 mars 2017	88
5.	Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116 të datës 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar	30 mars 2017	88
6.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar	30 mars 2017	88
7.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001, Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar	30 mars 2017	88
8.	Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”.	30 mars 2017	87
9.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar	6 prill 2017	73
10.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar	6 prill 2017	73
11.	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”	27 prill 2017	77
12.	Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9157, datë 04.12.2003 “ Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, i ndryshuar”	27 prill 2017	77
13.	Projektligji “Për tarifat dhe shpenzimet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”	2 nëntor 2017	73
14.	Projektligji “Për ndihmën juridike”	14 dhjetor 2017	73
15.	Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”	17 maj 2018	74
16.	Projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”	23 korrik 2018	76
17.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar	15 nëntor 2018	74
18.	Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”	22 nëntor 2018	77
19.	Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar	20 dhjetor 2018	76
20.	Projektligji “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore”	25 prill 2019	90
21.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar	13 dhjetor 2018	72
22.	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”	20 dhjetor 2018	76
23.	Projektvendim për “Për Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë”	18 prill 2019	86
24.	Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, të ndryshuar	9 maj 2019	90
25.	Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar		
26.	Projektligji “Për provimin e shtetit për profesionin e juristit”		
27.	Projektligji “ Për Presidentin e Republikës së Shqipërisë”		

* Miratimi i Projektligjeve të Paketës së Reformës në Drejtësi, Burimi: Kuvendi i Shqipërisë,
<https://www.parlament.al/Files/KalendariPunimeve/programi-punes-27-shkurt-7-prill-2017-perfundimtar.pdf>

ANEKS III – STATUSI I PROCESIT TË RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVE TË GJYKATAVE TË KRIMEVE TË RËNDA KANDIDATË PËR NË GJYKATAT E POSAÇME

Gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO			Statusi & Vendimi i KPK
Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda			
1.	Sandër Simoni	Kryetar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
2.	Dritan Hallunaj	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Konfirmuar (anëtar i KLGJ)
3.	Ardit Mustafaj	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
4.	Irena Gjoka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
5.	Daniela Shirka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
6.	Etleva Deda	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
7.	Luan Hasneziri	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Konfirmuar
8.	Flora Hajredinaj	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
9.	Fran Prendi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
10.	Ilirjana Olldashi	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
11.	Liljana Baku	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
12.	Marsela Balili	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
13.	Bib Ndreca	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
14.	Miliana Muça	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
15.	Klodian Kurushi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
Gjykata e Apelit për Krime të Rënda			
1.	Fehmi Petku	Kryetar/Gjykata e Apelit	Shkarkuar
2.	Gjovalin Pernoca	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
3.	Nertina Kosova	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar/APELUAR në KPA
4.	Dhurata Haveri	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
5.	Nure Dreni	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
6.	Saida Dollani	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
7.	Dhimitër Lara	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
8.	Sokol Binaj	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
9.	Amarildo Laçi	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
10.	Gurali Brahimllari	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
11.	Idriz Mulkurti	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
12.	Albana Boksi	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar

ANEKS IV– STATUSI I PROCESIT TË RIVLERËSIMIT TË PROKURORËVE KANDIDATË PËR NË PROKURORINË E POSAÇME

Kandidatët e KUALIFIKUAR për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (KKKO)			Raportet për Analizimin e Aftësive Profesionale	Statusi & Vendimi i KPK *
1.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë		Në proces rivlerësimi
2.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
3.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Në proces rivlerësimi
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme		Konfirmuar
5.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
6.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Në proces rivlerësimi
7.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Konfirmuar/ANKIMUAR
8.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
9.	Donika Prela	Drejtuese/Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda		Konfirmuar/ANKIMUAR
10.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
11.	Dritan Prençi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Konfirmuar
12.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
13.	Elida Kaçkini	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
14.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
15.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
16.	Enkeleda Millonai	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan		Në proces rivlerësimi
17.	Enkeleda Xhengo	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
18.	Eugen Beçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
19.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
20.	Maksim Sota	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
21.	Manjola Kajani	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
22.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
23.	Shkëlzen Cena	Prokuror/Prokuroria Dibrës	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
24.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi

Lista e kandidatëve të kualifikuar dhe përjashtuar për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), 5 Prill 2019: <http://klp.all/index.php/2019/04/05/vendime-date-05-04-2019/>

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 30 maj 2019

ANEKS V – KRITERET E POSAÇME ETIKE DHE PROFESIONALE TË VLERËSIMIT TË PROKURORËVE KANDIDATË PËR NË PROKURORINË E POSAÇME

Kriteret e Posaçme Etike dhe Profesionale (Ndjekja penale, hetimi, teknikat, përfaqësimi, konfiskimi & Vendosmëria dhe integriteti)			
	“Kualifikim i Lartë”	“Kualifikim i mesëm”	“Kualifikim i ulët”
	8-10 pikë	4-7 pikë	1-3 pikë
I Aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim	<p>a) ka hetuar me sukses jo më pak se pesë çështje penale të ndërlikuara ligjërish ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive;</p> <p>b) ka qenë drejtues grupi hetimor ose prokuror i vetëm dhe/ose ka përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli/Gjykatë të Lartë, në jo më pak se pesë procese gjyqësore për të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara;</p> <p>c) ka qenë pjesë e një grupi prokurorësh, në shkallë të parë ose në nivel apeli, në jo më pak se dhjetë procese gjyqësore, në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose për çështje të tjera të ndërlikuara;</p> <p>ç) ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive të cilat janë produkte të veprës penale në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e lartë ose ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e lartë.</p>	<p>a) ka hetuar me sukses jo më pak se tri çështje penale të ndërlikuara ligjërish ose në fakte përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive;</p> <p>b) ka qenë drejtues grupi hetimor ose prokuror i vetëm dhe/ose ka përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli / Gjykatë të Lartë, në jo më pak se pesë procese gjyqësore në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara;</p> <p>c) ka qenë pjesë e një grupi prokurorësh, në shkallë të parë ose në nivel apeli, në jo më pak se dhjetë procese gjyqësore, në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose për çështje të tjera të ndërlikuara;</p> <p>ç) ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive që përbëjnë produkte të veprës penale në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë mesatare ose ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia, në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë mesatare.</p>	<p>a) ka hetuar me sukses të paktën 1 çështje penale të ndërlikuara ligjërish ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive ose është përpjekur të hetojë çështje të ndërlikuara dhe të përdorë teknika të avancuara hetimi, por ka qenë i pasuksesshëm;</p> <p>b) nuk ka marrë pjesë në procese gjyqësore në të cilat është dhënë vendim për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose çështje të tjera penale të ndërlikuara;</p> <p>c) ka ndihmuar në të paktën një rast, një prokuror tjetër, i cili ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive që përbëjnë produkte të veprës penale dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e ulët ose ka ndihmuar në të paktën një rast, një prokuror tjetër, i cili ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia, dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e ulët.</p>
II Vendosmëria e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti	“Kualifikim i Lartë”	“Kualifikim i mesëm”	“Kualifikim i ulët”
	8-10 pikë	4-7 pikë	1-3 pikë
<p>Kandidatët i paraqesin Komisionit situatat/ rrethanat ku ata kanë kapërcyer vështirësi të spikatura ose i kanë bërë ballë presionit gjatë një hetimi ose ndjekjeje penale, duke bërë të mundur dërgimin e çështjes në gjyq. Kandidati përshkruan qartë vështirësitë dhe veprimet e kryera prej tij që kanë kontribuar në suksesin e hetimit ose ndjekjes penale.</p> <p>Kandidatët i paraqesin Komisionit situatat/ rrethanat ku ata kanë treguar etikë të lartë profesionale duke ruajtur paanësinë, ndershmërinë dhe konfidencialitetin e të dhënave hetimore pavarësisht vështirësive të spikatura me të cilat janë përballur.</p>	Në varësi të sasisë dhe cilësisë së situatave/rrethanave që kanë vënë në provë vendosmërinë dhe integritetin e kandidatit.	Në varësi të sasisë dhe cilësisë së situatave/rrethanave që kanë vënë në provë vendosmërinë dhe integritetin e kandidatit.	Në varësi të sasisë dhe cilësisë së situatave/rrethanave që kanë vënë në provë vendosmërinë dhe integritetin e kandidatit.

ANEKS VI – KRITERET E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS TË PROKURORËVE KANDIDATË PËR NË PROKURORINË E POSAÇME

Kriteri i Vlerësimit të Performancës (2 vlerësimet e fundit profesionale)					
	“Shumë mirë”	“Shumë mirë” dhe “Mirë”	“Mirë”	“Mirë” dhe “Mjaftueshëm”	“Mjaftueshëm”
	5 pikë	4 pikë	3 pikë	2 pikë	1 pikë
Viti paraardhës					
Viti i fundit					



CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes